



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/74
Datë: 16.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhja e 69 dhe 70 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/74
Datë: 16.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-069 për të Huajt, dhe duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, si dhe në rekomandimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Vendoset regjimi i vizave për shtetasit e shteteve të listuara në shtojcat I dhe II të këtij vendimi, të cilat janë pjesë përbërëse dhe detyruese e tij.
2. Shtetasit e shteteve të listuara në shtojcën I të këtij vendimi, para se të hyjnë në Republikën e Kosovës, pajisen me viza hyrëse për në Republikën e Kosovës në misionet konsullore dhe, sipas rastit, në misionet diplomatike të Republikës së Kosovës, ose siç përcaktohet në procedurat tjera të zbatueshme.
3. Shtetasit e shteteve të listuara në shtojcën II të këtij vendimi, pajisen me viza hyrëse për në Republikën e Kosovës në pikat kufitare të Republikës së Kosovës.
4. Shtetasit e shteteve të listuara në shtojcën I dhe II të këtij vendimi, lirohen nga detyrimi për t'u pajisur me vizë hyrëse për në Republikën e Kosovës, në rast se posedojnë vizë të vlefshme shumë-hyrëse *Schengen*. Këta persona mund të qëndrojnë në Republikën e Kosovës për një periudhë prej pesëmbëdhjete (15) ditëve.
5. Regjimi i vizave nuk zbatohet ndaj shtetasve të shteteve që nuk janë të listuara në shtojcat I dhe II të këtij vendimi, si dhe ndaj poseduesve të dokumenteve të udhëtimit të Kombeve të Bashkuara.

6. Ky vendim nuk paragjykon detyrimet që dalin nga marrëveshjet e lidhura ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera në lidhje me zbatimin e regjimit të vizave ose vizave për kategori të caktuara.
7. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme, që në afat prej tre (3) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të miratojnë kornizën e nevojshme ligjore për procedurat e lëshimit të vizave për të huaj.
8. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, derisa regjimi i vizave fillon së zbatuari nga data 1 janar 2013.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I:

1. Afganistani;
2. Algjeria;
3. Angola;
4. Armenia;
5. Azerbajxhani;
6. Bangladeshi;
7. Bjellorusia;
8. Benini;
9. Bolivia;
10. Burkina Faso;
11. Burundi;
12. Çadi;
13. Eritrea;
14. Etiopia;
15. Gaboni;
16. Gambia;
17. Gana;
18. Guinea Ekuatoriale;
19. Guinea;
20. Guinea-Bisau;
21. India;
22. Indonezia;
23. Iraku;
24. Irani;
25. Jemeni;
26. Kamboxha;
27. Kameruni;
28. Kape Verde;
29. Kazakistani;
30. Kenia;
31. Kirgistani;
32. Kuba;
33. Laosi (Republika Popullore Demokratike e);
34. Lebanoni;
35. Liberia;
36. Libia;
37. Majanmari;
38. Mali;
39. Maroku;
40. Mauritania;
41. Moldavia;
42. Mongolia;
43. Mozambiku;

44. Nepali;
45. Nigeri;
46. Nigeria;
47. Pakistani;
48. Republika Demokratike e Kongos;
49. Republika e Afrikës Qendrore;
50. Republika e Kongos;
51. Republika Popullore Demokratike e Koresë;
52. Ruanda;
53. Rusia;
54. Siera Leone;
55. Siria;
56. Somalia;
57. Sudani;
58. Shri Lanka;
59. Tajlanda;
60. Tanzania;
61. Taxhikistani;
62. Togo;
63. Tunizia;
64. Turkmenistani;
65. Uganda;
66. Ukraina;
67. Unioni i Komoreve;
68. Uzbekistani;
69. Vietnami;
70. Xhibuti;
71. Zambia;
72. Zimbabve.

Shtojca II:

1. Bregu i Fildishtë;
2. Butani;
3. Egjipti;
4. Ekuadori;
5. Filipinet;
6. Gjeorgjia;
7. Haiti;
8. Kina;
9. Madagaskari;
10. Peru;
11. Republika Dominikane;
12. Senegali;
13. Surinami;
14. Xhamajka.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/74
Datë: 16.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-203 për Metrologji.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/74
Datë: 16.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-216 për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave në Kosovë.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/74
Datë: 16.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Projektligjin për Institutin Kosovar për Administratë Publike.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë